



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC - BASIC COURT OF FERIZAJ

GJA.nr.47/2024

Datë 16 janar 2024

PLANI DHE PROGRAMI I
PUNËS I GJYKATËS
THEMELORE NË FERIZAJ
DHE DEGËT E SAJË PËR
VITIN 2024

*Ky Plan dhe Program Vjetor i Punës së Gjykatës Themelore në Ferizaj, është
aprovuar në mbledhjen e rregullt të kolegjiut të gjyqtarëve të gjykatës më datë
12 janar 2024, dhe si i tillë konsiderohet version final dhe i gatshëm për
implementim gjatë vitit 2024, pas aprovimit të këtij plani edhe nga Këshilli
Gjyqësor i Kosovës.*

Fjala e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj.....	4
Përmbledhje:.....	6
I. Organizimi i punës së Gjykatës Themelore në Ferizaj.....	8
II. Funkcionet gjyqësore dhe Udhëheqja e Departamenteve-divizioneve.....	8
II.1 Departamenti për Krime të Rënda	9
II.2 Në Departamentin për të Mitur.....	9
II.3 Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil.....	9
II.4 Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal.....	10
II.5 Në Departamentin e Përgjithshëm – divizioni për kundërvajtje.....	11
III. Udhëheqësit e Departamenteve dhe gjyqtarët përgjegjës të divizioneve.....	11
IV. Përbërja e Kolegjeve dhe ndarja e lëndëve sipas trupit gjykues.....	12
V. Kolegjet shqyrtuese.....	12
VI. Ndarja e lëndëve.....	13
VII. Procedura Paraprake.....	13
VIII. Degët e Gjykatës.....	14
IX. Ndihma Juridike Ndërkombëtare.....	15
X. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre.....	15
XI. Mbledhjet e kolegjiut të gjithë gjyqtarëve, departamenteve dhe divizioneve.....	16
XII. Orari i punës dhe respektimi i Kodit të Mirësjelljes.....	17
XIII. Trupi për Menaxhimin e Krizave.....	18
XIV. Zbatimi i programit TIK/SMIL.....	18
XV. Transparenca dhe Llogaridhënia.....	18
XVI. Administrata Gjyqësore.....	19

Programi për zgjidhjen efikase të lëndëve për vitin 2023

1. Departamentet e gjykatës Prioritetet dhe rekomandimet për vitin 2024	20
1.1. Departamenti për Krime të Rënda	20
1.2. Departamenti për të Mitur	22

1.3.	Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal	22
1.4.	Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil	27
1.5.	Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje	29
2.	Komunikimi me Institucione veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprimtarinë e Gjykatës	30
3.	Përfundimi.....	31

FJALA E KRYETARIT

Përfundimi i proceseve gjyqësore në kohë sa më të arsyeshme; ngritja e cilësisë së vendimeve me qëllim që vendimet të kenë arsyetimet e mjaftueshme përmbajtjesore, siç përcaktohet edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriu, po ashtu edhe në pajtueshmëri të plotë me standardet e tjera ndërkombëtar dhe ligjet në fuqi, reduktimi apo eliminimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore; rritja e transparencës, besueshmërisë të qytetarët dhe llogaridhënia, edhe këtë vite do të jenë vetëm disa nga objektivat e Planit dhe Programit të Punës së Gjykatës Themelore në Ferizaj për vitin 2024.

Avancimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të gjykatës në drejtim të përvojave funksionale dhe ndihmuese në gjykatë si dhe për të zgjeruar aftësinë e gjykatës drejt përfarimit me qytetarët, përmes përmirësimit të qasjes në drejtësi për qytetarët në modernizim të vazhdueshëm, si në aspektin e infrastrukturës, ndihmën e ofruar publikut përmes teknologjisë së informacionit të avancuar, si dhe ofrimin e informatave të ndryshme duke përfshirë, raportet e punës, publikimin e orarit të seancave gjyqësore, publikimin e vendimeve gjyqësore përmes portalit gjyqësore, me qëllim që ta bëjnë sa më të lehtë qasjen në drejtësi dhe rritjen e besueshmërisë, do të vazhdojnë të aplikohen dhe avancohen edhe gjatë vitit 2024.

Përmes këtij plani të punës përcaktohen prioritetet e vitit 2024, zbatimi i tyre dhe objektivat si; zbatimi dhe respektimi i ligjeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë; zbatimi dhe respektimi i planeve strategjike dhe të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zgjidhjen sa me efikase të lëndëve, komunikimit me media si dhe marrëdhëniet me akterët e tjerë, si dhe organizimi i punës së gjykatës dhe administratës gjyqësore.

Qëllimi i këtij plani të punës është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlihen me zgjidhjen e numrit të lëndëve.

Është e nevojshme që t'i konsolidojmë praktikat që janë treguar të suksesshme dhe produktive, t'i përmirësojmë praktikat të cilat nuk kanë dhënë rezultate, të ndërmerren veprime riparuese në funksion të tejkalimit të vështirësive të identifikuara.

Mustaf Tahiri

Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

PËRMBLEDHJE

Bazuar në nenin 14 pika 2.3 të Ligjit për Gjykatat (Ligji 06/L – 054), Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, pas marrjes së propozimit në mbledhjen e Kolegjiumit të gjyqtarëve të kësaj gjykate, përcakton Planin e Punës dhe Programin për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, të gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Ferizaj për vitin 2024.

Plani i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve për vitin 2024, është strukturuar në atë mënyrë që të avancoj aktivitetet dhe rezultatet në punë, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Themelore në Ferizajt, si në aspektin e organizimit profesional, ashtu edhe në atë administrativo teknik, realizimi i të cilave do të bëhet përmes aktiviteteve të arritshme brenda periudhës një vjeçare.

Ky plan program paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2024, ndër të tjera përcakton: organizimin e punës në Gjykatën Themelore në Ferizaj, organizimin e punës së administratës gjyqësore, funksionet gjyqësore, emërimin e udhëheqësve të Departamenteve dhe Përgjegjësit e Divizioneve, përbërjen e Kolegjeve, ndarjen e lëndëve gjyqësore, procedurën paraprake, orarin e punës, kodin e mirësjelljes, caktimin e shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre, publikimi i aktgjykimeve, planifikimin e mbledhjeve të kolegjiumit të gjyqtarëve të gjykatës, zbatimin e programit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve - SMIL, prioritet e departamenteve të gjykatës dhe rekomandimet për departamentet përkatëse etj.

Qëllimi i këtij dokumenti, është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e numrit të lëndëve.

Gjatë këtij viti monitorimi i zbatimit të planeve strategjike të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, siç është Plani Strategjik Për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Plani Strategjik për Përmirësimi e Qasjes në Drejtësi dhe në përgjithësi zbatimi i planit të punës së gjykatës dhe raportimi mbi zbatimin e këtyre planeve strategjike do të jenë në fokus të punës së Kryetarit të Gjykatës, Gjyqtarëve Mbikëqyrës dhe udhëheqësve të Departamenteve dhe Divizioneve brenda gjykatës, në mënyrë që gjykimet e çështjeve gjyqësore të jenë brenda afateve ligjore, duke respektuar prioritetet ligjore dhe prioritetet e vendosjes së lëndëve siç përcaktohen me këto plane strategjike.

I. Organizimi i punës në Gjykatën Themelor të Ferizaj

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Ferizaj, udhëheqë kryetari i gjykatës. Në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës udhëheq nënkryetarja e gjykatës Mirlinda Bytyqi Rexhepi, për organizimin e punës së degës së Gjykatës në Kaçanik udhëheq – gjyqtari mbikëqyrës Burhan Berisha, ndërsa me Degën në Shtërpçë gjyqtari mbikëqyrës Alban Beqiri

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administroj administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Sejdi Sadiku. Për degën e gjykatës në Kaçanik ndihmës administratorja Kadishe Shabani, ndërsa Degën në Shtërpçë ndihmës administratorja Zorica Petkoviç.

II. Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve - Divizioneve

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Ferizaj, janë organizuar tre (3) Departamente:

- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilit funksionojnë këto Divizione;
 - Divizioni Penal

- Divizioni Civil dhe
- Divizioni për Kundërvajtje

Aktualisht në Gjykatën Themelore në Ferizaj janë të sistemuar njëzet e dy (22) gjyqtar përfshirë kryetari i gjykatës, (ndërsa njëri nga gjyqtarët është duke e ndjekur trajnimin fillestar për gjyqtar pranë Akademisë së Drejtësisë do të sistemohet në gjykatë në departamentin e përgjithshëm - divizioni civil), të cilët do të punojnë në kuadër të Departamenteve dhe Divizioneve si vijon, :

II.1 Në Departamentin për Krime të Rënda do të punojnë gjyqtarët:

- Mustaf Tahiri
- Sahit Krasniqi,
- Ilir Bytyqi,
- Fitore Daci
- Habib Zeqiri

Varësisht nga gjendja me lëndë në këtë departament, dhe nevojës së angazhimit të gjyqtarëve në departamente tjera, gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda në bazë të këtij plani të punës do të ngarkohen edhe me lëndë nga Departamenti i Përgjithshëm divizioni penal.

II.2, Në Departamentin për të Mitur, do të punoj gjyqtari Shabi Idrizi.

Sipas nevojës dhe varësisht nga ngarkesa me lëndë në këtë departament do të angazhohen edhe gjyqtarët tjerë nga Departamenti për Krime të Rënda. Në mungesë të gjyqtarit për të mitur Shabi Idrizi, dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtari mund të ketë pengesa ligjore në shqyrtimin e lëndëve për të mitur, i njëjti do të zëvendësohet nga gjyqtari Ilir Bytyqi, apo edhe gjyqtarët tjerë nga DKR.

II.3, Në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil do të punojnë këta gjyqtar:

- Mirlinda Bytyqi Rexhepi,

- Burim Emërllahu,
- Kreshnike Zymberi Beqiri
- Bekim Salihu,
- Lela Petkoviç,
- Faton Ajvazi
- Magdalena Millosheviq,
- Armend Ahmeti
- Driton Ahmeti

Gjyqtari Faton Ajvazi, do të vazhdoj të punoj me lëndët përmbare, prapësimet në procedurën civile, si dhe këndet e ekzekutimeve civile të cilat janë kompetencë të gjykatës. Në mungesë të gjyqtarit Faton Ajvazi, dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtari mund të ketë pengesa ligjore në shqyrtimin e lëndëve përmbare, i njëjti do të zëvendësohet nga gjyqtari Burim Emërllahu, apo edhe gjyqtarët tjerë nga divizioni civil. Gjyqtari Faton Ajvazi do të jetë përgjegjës dhe mbikëqyrë edhe punën e zyrës së ekzekutimeve civile.

Gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, do të punojë lëndët jashtë kontestimore, përkatësisht kërkesat për njohje të vendimeve të huaja. Në mungesë të gjyqtarës Mirlinda Bytyqi Rexhepi, dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtarja mund të ketë pengesa ligjore në shqyrtimin e njohjeve të këtyre vendimeve, e njëjta do të zëvendësohet nga gjyqtari Burim Emërllahu.

Gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, do të vazhdoj të jetë koordinatore për rastet e dhunës në familje në aspektin civil, e cila do të kujdeset që të gjitha lëndët që kanë gjyqtarët e lëmis civile që kanë të bëjnë me dhunë në familje të trajtohen me urgjence, dhe do të përpiloj raporte periodike me të cilat do të njoftohet koordinatori i caktuar nga KGJK.

II.4, Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal do të punojnë gjyqtarët;

- Hakile Ilazi,
- Adem Shabani,
- Imri Sejda,

- Mimoza Shabani (aktualisht në pushim lehozhie)
- Dardan Maloku.

Varësisht nga gjendja me lëndë në këtë departament, dhe nevojës së angazhimit të gjyqtarëve në divizione tjera, në bazë të këtij plani të punës gjyqtarët e divizionit penal do të ngarkohen edhe me lëndë të divizionit civil dhe atij të kundërvajtjes.

Me qëllim të efikasitetit sa më të lartë dhe trajtimin sa më të shpejtë të lëndëve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, të gjithë gjyqtarët e divizionit penal do të trajtojnë lëndët e rasteve të dhunës në familje, ashtu siç ndahen nga sistemi SMIL.

Koordinator për rastet e dhunës në familje caktohet gjyqtari Adem Shabani, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe trajtimin me urgjencë të këtyre rasteve nga gjyqtarët, dhe do të përgatitë raporte periodike lidhur me këto raste, ku edhe do të raportoj koordinatori të caktuar nga KGJK.

II.5, Në Departamentin e Përgjithshëm – divizioni për Kundërvajtje do të punojnë gjyqtarët;

- Nazife Beqiri dhe
- Bahri Salihu.

Në divizionin për Kundërvajtje për shkak të numrit të madh të lëndëve në këtë divizion sipas nevojës do të angazhohen edhe gjyqtarë tjerë nga Departamenti i Përgjithshëm – divizion penal.

Gjyqtarët mund të caktohen dhe ri-caktohen në departamente apo divizion tjetër, varësisht nga nevojat e gjykatës për të adresuar ngarkesën me lëndë, zvogëluar vonesat në kategoritë e caktuara të lëndëve dhe ngritur efikasitetin e gjykatës në përgjithësi, ndryshe nga sistematizimi i këtij plani.

III. Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtar përgjegjës të divizioneve caktohen:

- Ilir Bytyçi – Udhëheqës i Departamentit për Krime të Rënda;
- Shabi Idrizi - Udhëheqës i Departamenti për të Mitur;
- Mirlinda Bytyqi Rexhepi - Udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm,
- Adem Shabani - gjyqtar përgjegjës në Divizionit Penal;
- Bahri Salihu – gjyqtar përgjegjës në Divizionin për Kundërvajtje.

Udhëheqësit e Departamenteve dhe përgjegjësit e Divizionit, do t'i raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e Departamenteve - Divizionit, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit dhe përgjegjësit të divizionit, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.

Kryetari i Gjykatës, mund të kërkoj nga udhëheqësit e departamenteve ose gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

IV. Përbërja e Kolegjeve dhe ndarja e lëndëve sipas trupit gjykues

Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda, gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtar profesional, nga të cilët njëri duhet të jetë kryetar i trupit gjykues. Kryetarët e Trupave Gjykuese, mund të formojnë trupat gjykues vetë, duke marr parasysh edhe agjendat e gjyqtarëve, por për këtë e njoftojnë paraprakisht Kryetarin e Gjykatës lidhur me përbërjen e trupave gjykues.

Të gjitha çështjet në Departamentin e Përgjithshëm gjykohen nga një (1) gjyqtar i vetëm, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Në Departamentin për të Mitur trupi gjykues udhëhiqet konform Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

V. Kolegjet Shqyrtuese

Kolegji shqyrtues përbehet prej tre (3) gjyqtarëve për të shqyrtuar dhe gjykuar një kundërshtim kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Kryetari i gjykatës konform nenit 418 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), cakton kolegjin shqyrtues prej tre (3) gjyqtarëve në departamentet përkatëse. Në rast se nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve, kryetari i gjykatës mund të caktojë gjyqtarët nga ndonjë departament tjetër për të shërbyer në kolegjin shqyrtues.

Në rast të ndonjë pengese që ndonjëri nga gjyqtarët e caktuar në kolegji, të mos mund të ushtroj funksionin në çështje të caktuara, të njëjtit zëvendësohen nga gjyqtarët e tjerë dhe po ashtu nga kryetari i gjykatës.

VI. Ndarja e lëndëve

Ndarja e lëndëve në punë për secilin gjyqtarë bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve – SMIL. Nëse gjyqtarit të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, kërkesa për përjashtim duhet të bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve –SMIL.

VII. Procedura paraprake

Ky plan i punës për vitin 2024, po ashtu përcakton se gjyqtarët në procedurën paraprake në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe Degë janë si vijon:

- **Departamenti për Krime të Rënda**
- Sahit Krasniqi; Ilir Bytyqi; Fitore Daci dhe Habib Zeqiri
- **Divizioni Penal**
 - Hakile Ilazi, Adem Shabani; Mimoza Shabani, Imri Sejda dhe Dardan Maloku
 - Për degën në Kaçanik gjyqtarët: Riza Livoreka dhe Burhan Berisha.
 - Për degën në Shtërpçë gjyqtari mbikëqyrës: Alban Beqiri.

- **Departamentin për të Mitur**

- Shabi Idrizi, në rast mungese të gjyqtarit kujdestar, i njëjti zëvendësohet nga gjyqtari Ilir Bytyçi, apo edhe gjyqtarët tjerë të Departamentit të Krime të Rënda.

Gjyqtarët në procedurën paraprake duhet të jenë në gatishmëri të detyrës për një javë, mbi baza rotative dhe të barabarta. Në rast mungese të gjyqtarit kujdestar, zëvendësohet nga gjyqtari i cili është kujdestar sipas radhës së ardhshme vijuese.

Gjyqtaret e procedurës paraprake, të cilët kanë lëshuar Urdhëresa Gjyqësore Konfidenciale (UGJK), do të vendosin edhe për kërkesat për sigurimin e te pandehurit, po ashtu gjyqtarët që kanë vendosur mbi kërkesat për sigurimin e prezencës së të pandehurit (paraburgim, arrest shtëpiak etj), do të vendosin edhe UGJK dhe të gjitha kërkesat e tjera që kanë të bëjnë me atë lëndë, pavarësisht se të njëjtat mund të pranohen në javën që nuk janë kujdestar.

VIII. Degët e Gjykatës

Degët e Gjykatës Themelore në Ferizaj janë: në Kaçanik dhe Shtërpçë të cilat funksionin gjyqësor e kryejnë përmes Departamentit të Përgjithshëm, ndërsa secila degë e Gjykatës, ka gjyqtarin mbikëqyrës i cili është përgjegjës për punën e degës.

Në degën e Gjykatës në Kaçanik do të punojnë gjyqtarët:

- Burhan Berisha – Gjyqtar Mbikëqyrës - Gjyqtar në lëmin civile, njëkohësisht i angazhuar si gjyqtar i procedurës paraprake,
- Zajrete Muhaxheri – Gjyqtare në lëmin penale, njëkohësisht angazhohet për lëndët e kundërvajtjes,
- Riza Livoreka – Gjyqtar në lëmin civile, njëkohësisht do të shërbej si gjyqtar i procedurës paraprake;
- Burim Çaka - Gjyqtar në lëmin penale, njëkohësisht angazhohet për lëndët e kundërvajtjes.

Gjyqtarët Zajrete Muhaxheri dhe Burim Caka në lëndët e kundërvajtjes do të punojnë në baza proporcionale.

Në Degën e Gjykatës në Shtërpcë do të punojnë gjyqtarët:

- **Alban Beqiri** – Gjyqtar mbikëqyrës - njëkohësisht i angazhuar si gjyqtar i lëmisë civile. (Në mungesë të gjyqtarit Alban Beqiri dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtari mund të kenë pengesa ligjore në shqyrtimin e lëndëve, i njëjti do të zëvendësohet me gjyqtar nga Gjykata Themelore sipas SMIL).
- **Ivana Milenkoviç** - Gjyqtare në lëmin Penale dhe Kundërvajtje, (në mungesë të gjyqtares Ivana Milenkoviç, dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtarja mund të kenë pengesa ligjore në shqyrtimin e lëndëve, do të zëvendësohet me gjyqtar nga Gjykata Themelore sipas SMIL)
- Gjyqtari mbikëqyrës, **Alban Beqiri** do të angazhohet si gjyqtar i procedurës paraprake në divizionin penal (Në mungesë të gjyqtarit Alban Beqiri dhe në rastet e përjashtimit apo rrethane tjetër sipas të cilave gjyqtari mund të kenë pengesa ligjore në shqyrtimin e lëndëve, i njëjti do të zëvendësohet me gjyqtar nga Gjykata Themelore sipas SMIL).

Gjyqtarja Magdalena Millosheviç dhe Lela Petkoviç, për shkak të numrit të vogël të lëndëve në degën e Shtërpcës, do të vazhdojnë të angazhohen në Divizionin Civil në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

IX. Ndhimja Juridike Ndërkombëtare

Kryetari i Gjykatës Themelore, vendos në çdo rast kur kërkohet ndihma juridike ndërkombëtare (*përveç kur për kërkesë duhet të vendos kolegji*) dhe për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja, si dhe në rastet e tjera kur me ligj është përcaktuar kompetenca e kryetarit të Gjykatës Themelore.

X. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre

Shqyrtimet gjyqësore caktohen nga gjyqtarët, përkatësisht kryetarët e trupave gjykuese konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Orari i seancave gjyqësore regjistrohet në SMIL dhe njëkohësisht publikohet në ueb portalin gjyqësor. Gjithashtu përmes sistemit të SMIL-it, do të plotësohen edhe të dhënat lidhur me arsyet e shtyrjeve dhe anulimit të seancave gjyqësore.

XI. Mbledhjet e kolegjiut të gjithë gjyqtarëve, departamenteve dhe divizioneve

Mbledhjet e kolegjiut të të gjithë gjyqtarëve do të mbahen konform edhe Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave nr. 02/2020, së paku një (1) herë në muaj, po ashtu së paku (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të departamenteve dhe të divizioneve përkatëse:

- Së paku një (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Departamentit për Krime të Rënda;
- Së paku një (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit Penal;
- Së paku një (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit Civile;
- Së paku një (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit për Kundërvajtje.

Kryetari i gjykatës thërret kolegjiutin vjetor te gjykatës. Në kolegjiutin vjetor behet shqyrtimi i punës dhe funksionimit të gjykatës gjate vitit të kaluar po ashtu caktimi i gjyqtareve në departamente dhe divizione të gjykatës, përbërja dhe menaxhimi i kolegjeve

për t'i gjykuar çështjet që kërkojnë trup gjykues, plani vjetor i punës së gjykatës për vitin e ardhshëm, dhe çështje tjera të përcaktuara nga kryetari i gjykatës në konsultim me gjyqtaret.

Sipas nevojës mbledhjet e kolegjiut mund të thirren në çdo kohë.

Kryetari i gjykatës thërret kolegjiutin e gjyqtareve ne gjykate për te diskutuar lidhur me administrimin e gjykatës, për të shqyrtuar organizimin e punës, rezultatet e arritura në gjykate dhe për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e punës.

Pjesëmarrja në kolegjiute dhe mbledhjet e departamenteve dhe divizione, është e obligueshme.

Kolegjiuti i gjyqtareve, në mbledhjet e tij nxjerre edhe rekomandime te cilat duhet të përfillen nga kryetari i gjykatës, nënkryetari, gjyqtari mbikëqyrës, stafi gjyqësor dhe stafi administrativ. Rendi i ditës për mbledhjen e kolegjiut të gjyqtarëve përcaktohet nga kryetari i gjykatës.

Administratori mbështet kryetarin e gjykatës në organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të kolegjiut të gjyqtareve, i cili njofton gjyqtaret të paktën shtatëdhjetë (72) orë para mbledhjes, furnizon gjyqtarët me materialet e rëndësishme të mbledhjes, dhe mban procesverbalin për rrjedhën e mbledhjes, të cilat procesverbale paraprakisht iu dorëzohen gjyqtarëve të gjykatës, për të paraqitur vërejtjet e tyre eventuale, pastaj miratohen në kolegjiutin e radhës. Të gjitha dokumentet e takimeve të kolegjiut të gjykatës duhet të arkivohen në dosje të veçanta

XII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 dhe zgjatë deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 13:00, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Themelore në Ferizaj, janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës, duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përdorimi apo aktivitetet e zyrtareve të gjykatës, përfshirë gjyqtarët në rrjetet sociale duhet të jenë të përgjegjshme dhe të paraqiten në mënyrë korrekte, ndërsa vendosja e fotografive dhe postimeve të ndryshme, duhet të jetë e kujdesshme në nivelin e paraqitjeve korrekte.

XIII. Trupi për Menaxhimin e Krizave

Trupi Menaxhues i Krizave i Gjykatës Themelore në Ferizaj, do të jenë në përbërja nga: Kryetari i Gjykatës – Udhëheqës i Trupës Menaxhuese, Gjyqtarët Mbikëqyrës të Degëve dhe do të shërbejë për Menaxhimin e Krizave e Gjykatës Themelore në Ferizaj në raste dhe situatat emergjente shëndetësore, katastrofat natyrore, kërcënimeve të sigurisë apo rrethana të tjera të natyrave të ngjashme në të ardhmen.

XIV. Zbatimi i programit TIK/SMIL

Gjykata Themelore në Ferizaj do të punoj në tërësi duke aplikuar dhe implementuar Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), duke u bazuar në rregulloren për përdorimin e këtij sistemi, e cila përcakton rregullat, rolin dhe detyrat e gjyqtareve, si dhe stafit administrativ në përdorimin e SMIL në punën e tyre gjatë procedimit të lendeve përmes sistemit. Po ashtu këtë vit do të kushtohet vëmendje e theksuar mbikëqyrjes së përdorimit sa më të saktë të këtij sistemi nga të gjithë përdoruesit, po ashtu do të organizohen trajnime të veçanta me secilin përdorues të këtij sistemi, qoftë në mënyrë grupore apo edhe veç e veç me secilin përdorues që ka nevojë në ngritjen e aftësive në përdorimin e sistemit.

XV. Transparenca dhe llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, si dhe duke u bazuar edhe në Strategjinë e Komunikimit të miratuar nga KGJK-ja për një gjyqësor më transparent dhe të qasshëm, gjykata do të informojë publikun rregullisht mbi punën dhe aktivitetet e gjykatës. Publiku në baza ditore do të kenë qasje në orarin e seancave gjyqësore të çështjeve penale, civile apo të kundërvajtjes i cili do të publikohet në ueb faqen e gjykatës. Po ashtu publiku do të ketë qasje në statistikën e gjykatës, raportet e punës, statistikën e performancës së gjyqtarëve, planin dhe programin vjetor të punës do të jenë të qasshme për të gjithë, me çka publikut do t'i mundësohet qasje e gjerë në aktivitetet e gjykatës, për të cilat publiku njëkohësisht do të mund të informohet edhe përmes rrjetit social facebook.

Ueb faqja e gjykatës po ashtu ofron mundësinë edhe për kërkimin e Statusit të Lëndës dhe njëkohësisht aplikimin online e qytetarëve për certifikatën mbi dënimet penale.

Të gjitha aktgjykimet penale, civile dhe të gjitha aktvendimet meritore, do të publikohen në ueb portalin gjyqësor të Republikës së Kosovës, konform Ligjit për Gjykatat, dispozitave të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjytimeve, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

XVI. Administrata Gjyqësore

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administroj Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Sejdi Sadiku. Për degën e gjykatës në Kaçanik ndihmës administratorja Kadishe Shabani ndërsa Degën në Shtërpçë ndihmës administratorja Zorica Petkoviç.

Administratori i Gjykatës menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Në mungesë të administratorit të gjykatës, detyrën e tij e ushtron përkohësisht Shefi i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Kryetari i gjykatës.

I. Prioritetet e Departamenteve të Gjykatës dhe Rekomandimet për vitin 2024

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj në Kaçanik dhe në Shtërpcë, do të jetë në fokus zbatimi i planeve strategjike dhe atë Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, si dhe Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024. Po ashtu prioritet i këtij plani të punës do të jetë reduktimi i numrit të lëndëve të vjetra, përkatësisht rritja e efikasitetit në trajtimin dhe zgjidhjen e lëndëve të vjetra që janë më të vjetra se 24 muaj dhe rasteve të natyrës prioritare sipas ligjit të lëmive penale dhe asaj civile.

Në kuadër të kësaj zyra e statistikave në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, dhe secilin gjyqtar veçse e kanë të identifikuar numrin e lëndëve dhe ngarkesën me lëndë për secilin gjyqtar, përfshirë numrin e lëndëve me të vjetra se 24 muaj, numrin e lëndëve të kthyer në rigjykim, numrin e lëndëve të korrupsionit dhe numrin e lëndëve që për nga ligjet dhe planet strategjike janë të listuara si lëndë me prioritet.

Andaj, me qëllim të zbatimit sa më të suksesshëm dhe më efikas të lëndëve të vjetra dhe atyre me prioritet që hyjnë në kuadër të këtyre planeve strategjike Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, si dhe Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024, kërkohet që secili gjyqtar të ketë angazhim maksimal dhe një aplikim të metodave efikase në drejtim të zgjidhjes së këtyre lëndëve në afat kohor sa më të shpejtë.

➤ Prioritetet e Departamentit për Krime të Rënda

Prioriteti i Departamentit për Krime të Rënda do të jetë zgjidhja e lëndëve që janë me prioritet ligjor, e që këto lëndë duhet të trajtohen në bazë të planit Strategjik Për Zgjidhje Efikase të Lëndëve Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024 dhe Zbatimi i Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilat përcaktojnë trajtimin e lëndëve brenda afatit të arsyeshëm kohor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe me instrumente ndërkombëtare të zbatuara.

Përpos lëndëve që janë në prioritet ligjorë, prioriteti i këtij departamenti do të jetë kryerja e të gjitha lëndëve të cilat hyjnë në kategorinë e lëndëve sipas strategjive të cekura si më lartë, e që kanë të bëjnë me: Veprat penale kundër detyrës zyrtare (korrupsioni) – trajtimi i këtyre lëndëve duhet të ketë prioritet të lartë nga secili gjyqtar, pasi që trajtimi i këtyre rasteve me efikasitet ndikon në ndërtimin e imazhit pozitiv të gjyqësorit dhe rrit besimin e publikut. Trajtimi i lëndëve të kthyer në rigjykim, duhet të bëhet duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Veprat penale dhunë në familje – trajtimi i këtyre veprave penale gjyqtarët duhet të kujdesen që të trajtohen në afatin sa më të shkurtër kohorë dhe seancat të caktohen brenda një periudhe të caktuar dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhje e çështjes, pasi që mos trajtimi i tyre ka ndikim negativ brenda familjes dhe shoqërisë dhe mund të sjell pasoja të pariparueshme. Trajtimi i lëndëve ku viktimat janë të ndjeshëm, gjyqtarët duhet të kujdesen që këto raste të trajtohen brenda afatit të shkurtër kohor. Lëndët më të vjetra se dy vite – gjyqtarët duhet të respektojnë afatet e arsyeshme kohore sa i përket trajtimit të lëndëve për faktin se kjo ndikon negativisht në uljen e besimit të qytetarëve në gjyqësor.

Përpos kësaj, gjyqtarët duhet të kushtojnë vëmendje të posaçme lëndët që janë me paraburgim, në mënyrë që të njëjtat të trajtohen me prioritet ashtu siç përcaktohet me ligj, dhe mos të ketë zvarritje të këtyre çështjeve.

Për të gjitha lëndët e këtyre kategorive, duhet të ndërmerren të gjitha masat e mundshme ligjore që të përfundohen sa më shpejt, pasi përfundimi i tyre ka një rëndësi të veçantë, jo vetëm për gjykatën dhe sistemin e drejtësisë, por për mbarë vendin, pasi nga kjo do të ketë

ndikim pozitiv në forcimin e sundimit të ligjit dhe ngritjen e sigurisë së përgjithshme në shoqëri.

➤ **Rekomandimet për këtë vit:**

- *Të zbatohen në përpikmëri Planet Strategjike të miratuara nga Këshilli Gjyëqsor i Kosovës siç janë Planit Strategjik Për Zgjidhje Efikase të Lëndëve Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024 dhe Zbatimi i Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025.*

- Të eliminohen shtyrjet e panevojshme;
- Të shkurtohet numri i seancave gjyqësore për ta përfunduar çështjen (përkundër faktit se natyra e çështjeve është më komplekse dhe serioze, numri i seancave të planifikuara duhet të jetë racional, i arsyeshëm. Seancat gjyqësore të planifikohen dhe të caktohen në bllok);
- Të ketë një klasifikim të diferencuar të lëndëve si: komplekse, standarde dhe të thjeshta dhe varësisht nga ky klasifikim të planifikohet përfundimi i tyre;
- Zbatimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore dhe zbatimi i udhëzuesit të veçantë për veprat penale të korrupsionit, nga të gjithë gjyqtarë do të ishte mekanizëm i mirë në unifikimin e politikës ndëshkimore, në kuadër të departamentit dhe gjykatës në përgjithësi, dhe do të ndikonte që të ketë një konsistencë dhe trajtim më të barabartë të qytetarëve para ligjit, njëkohësisht do të rrisë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë që janë komponente të rëndësishme për një shoqëri në të cilën mbizotëron sundimi i ligjit.
- Koordinim më i mirë i gjyqtarëve të këtij departamenti për formimin e kolegjeve, në mënyrë që sa të jetë e mundur të minimizohet nevoja për gjyqtarë nga departamenti i përgjithshëm dhe përbërja e trupave gjykues me gjyqtar jashtë DKR të jetë përjashtim, *(ngase kjo po reflektohet në vëllimin e punëve në divizionet nga vijnë këta gjyqtarë).*

➤ **Prioritetet e Departamentit për të Mitur**

Edhe në këtë departament përpos lëndëve që janë në prioritet ligjorë, prioritet është zbatimi i Planin Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Ndër lëndët që do të trajtohen me prioritet duhet të jenë trajtimi i lëndëve penale për të mitur që janë me masë të paraburgimit.

Lëndët e kthyer në rigjykim të cilat duhet të procedohen brenda afateve të përcaktuara sipas ligjit, gjithashtu gjyqtari duhet të kujdeset që seancat për këto çështje të mbahen brenda një periudhe të caktuar kohore dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes, pasi që njëra ndër parimet e përcaktuara sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur është se procedura ndaj të miturve është procedurë urgjente dhe duhet të zhvillohet duke marrë parasysh interesin më të mirë dhe mirëqenien më të mirë ndaj të miturit.

Po ashtu trajtimi i veprave penale kundër intergritetit seksual, veprave penale të narkotikëve dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, gjyqtari duhet të kujdesët të njëjtat ti trajtojë brenda një afati sa më të shkurtër dhe seancat të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes. Trajtimi i lëndëve të kthyer në rigjykim, duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, duke u kujdesur që seancat të mbahen brenda një periudhe të caktuar kohore dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes. Trajtimi i rasteve dhunë në familje, gjyqtarët duhet të kujdesën që të trajtohen në afatin sa më të shkurtër kohorë dhe seancat të caktohen brenda një periudhe të caktuar dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhje e çështjes, pasi që mos trajtimi i tyre ka ndikim negativ brenda familjes dhe shoqërisë dhe mund të sjell pasoja të pariparueshme.

Rekomandimet për këtë vit:

- Të zbatohen në përpikmëri Planin Strategjik të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës siç janë Zbatimi i Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025.
- Të eliminohen shtyrjet e panevojshme të seancave gjyqësore;
- Të përfundohen të gjitha lëndët që janë në kompetencë të Departamentit për të Mitur mbrenda afateve të përcaktuara ligjore;

➤ Departamenti Përgjithshëm / Divizioni Penal

Prioritet i këtij departamenti do të jetë zgjidhja e lëndëve që janë me prioritet ligjor, dhe atyre që hyjnë në kuadër të planit Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilat përcaktojnë trajtimin e lëndëve brenda afatit të arsyeshëm kohor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe me instrumente ndërkombëtare të zbatuara.

Lëndët që për shkak të natyrës dhe thjeshtësisë konsiderohen të lehta për t'u zgjidhur, duhet të ndërtohen praktika standarde dhe të konsoliduara në mënyrë që të përfundohen më shpejt dhe me angazhime minimaliste, në këto lëndë nuk duhet të teprohet me shtyrje dhe seanca të panevojshme.

➤ **Prioritetet e këtij departamenti**

Prioritet i Departamenti Përgjithshëm / Divizioni Penal, përpos lëndëve që janë në prioritet ligjorë, prioritet i këtij departamenti do të jetë trajtimi i lëndëve të përcaktuara sipas Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

- Trajtimi me prioritet i lëndëve që rrezikojnë parashkrimin në afat më pak se gjashtë muaj, duke u kujdesur që seancat të caktohen në afate sa më të shkurta kohore dhe në mënyrë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e tyre, pasi që mos trajtimi i tyre dhe arritja e afateve të parashkrimeve ndikon në imazhin e sistemit të drejtësisë dhe besimin e qytetarëve.
- Trajtimi me prioritet i lëndëve të kthyer në rigjykim, duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, duke u kujdesur që seancat të mbahen brenda një periudhe të caktuar kohore dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes,
- Trajtimi i rasteve dhunë në familje, gjyqtarët duhet të kujdesën që të trajtohen në afatin sa më të shkurtë kohorë dhe seancat të caktohen dhe të jenë të vazhdueshme

deri në zgjidhje e çështjes, pasi që mos trajtimi i tyre ka ndikim negativ brenda familjes dhe shoqërisë dhe mund të sjell pasoja të pariparueshme,

- trajtimi i lëndëve me të vjetra se dy vite, trajtimi i rasteve për veprat penale kundër integritetit seksual, veprave kundër jetës dhe trupi, veprat penale kundër mjedisit me theks të veçantë veprat penale vjedhje pylli.
- Trajtimi i rasteve penale ku viktimat janë personat e ndjeshëm apo kategoritë e marginalizuara,
- Trajtimi me prioritet i rasteve kur të pandehurit kanë dy apo me tepër aktakuza, si dhe
- trajtimi me prioritet i lëndëve penale ku kryes janë personat me çrregullime mendore duhet që gjyqtarët të kujdesen që këto raste të trajtohen brenda afatit sa më të shkurtë duke respektuar legjislacionin në fuqi si dhe instrumentet ndërkombëtare.

➤ **Rekomandimet për këtë vit:**

- Të aplikohet standardi që lëndët të treshresëzohen duke i ndarë: në të thjeshta (të cilat mund të kryhen me angazhim minimal apo modest të gjyqtarit, siç mund të jenë urdhrat ndëshkimesor, lëndët me pranim të fajësisë, lëndët e vendosura jashtë shqyrtimit gjyqësor, apo referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit); Lëndët standarde (lëndët tipike që kryhen me angazhimin normal të gjyqtarëve që kërkon mbajtjen e seancave, dëgjimin e dëshmitarëve, të pandehurit, administrimin e provave). Lëndë të komplikua (përfshihen lëndët me numër të madh të pandehurve, disa vepra penale apo numër i madh i dëshmitarëve);
- Planifikim më i mirë sa i përket caktimit të lëndëve, duke i identifikuar lëndët në të cilat ka gjasa reale apo në bazë të deklarimeve të mëparshme është e pritshme pranimi i fajësisë. Si rezultat i saj caktimi i një numri më të madh të tyre, (kur i pandehuri në deklarin e tij në procedurën hetimore para prokurorit të shtetit ka pranuar fajësinë) brenda një dite mund të rezultoi me përfundimin e më shumë lëndëve. Apo edhe caktimi i seancave të natyrës së njejtë brenda një dite ku palët janë të njëjta, psh. lëndët me vepra penale vjedhje pylli (pala e dëmtuar dhe shumica e dëshmitarëve janë të njejtë), veprat penale vjedhja e shërbimeve komunale (pala e dëmtuar KEDS dhe shumica e dëshmitarëve janë të njejtë), do të ishte më produktive për zgjidhjen e lëndëve.

- Caktimi i numrit të vogël të këtyre lëndëve mund ta dërgoj gjyqtarin në një ditë të dështuar apo jo produktive si psh: ka caktuar vetëm dy lëndë, dhe njëra është përfunduar, por lënda tjetër nuk është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, ngase nuk është paraqitur i pandehuri, ashtu gjyqtari ka arritur të kryej vetëm një lëndë brenda një dite, edhe pse po të menaxhonte më mire supozojmë se ka caktuar më shumë lëndë dhe të pandehurit kanë pranuar fajësinë do të arrinte të përfundonte më tepër lëndë, andaj rekomandohet që në raste të tilla të caktohen sa më shumë lëndë;
- Të bëhen përpjekje që të eliminohen seancat e dështuara duke u kujdesur përmes zyrtarëve ligjor dhe bashkëpunëtorëve profesional që paraprakisht dhe në vazhdimësi para seancave lëndët të përfundohen brenda një seance dhe kjo të jetë një rregull, ndërsa shtyrjet të jenë një përjashtim dhe të bëhen vetëm mbi bazat e propozimeve të justifikueshme të cilat thelbësisht i kontribuojnë çështjes, dhe jo të aprovohen propozimet nga palët pa një vlerësim dhe vështrim kritikë. Në këtë mënyrë pretendohet të eliminohet kultura e shtyrjeve të panevojshme;
- Politika ndëshkimore duhet të rishikohet veçanërisht tek disa vepra të cilat për nga natyra dhe shtrirja e tyre meritojnë që kryesve të tyre të ju shqiptohen dënime më të ashpra. Këto vepra mund të jenë p.sh: rastet e dhunës në familje, vjedhjet e rënda, mashtrimi, lëndimi i rëndë trupor etj. Është e pajustificueshme shqiptimi i dënimeve minimale në rastet të cilat nuk përkojnë peshën dhe seriozitetin e rrezikshmërisë konkrete të veprës penale dhe kryerësit, e në veçanti kujdes duhet ti kushtohet kryesve të veprave penale vjedhja e pyllit, tek të cilat na paraqiten kryesisht personat recidivistë, ndaj tyre duhet të kihet parasysh kjo rrethanë me rastin e matjes së dënimit, ngase është jashtë çdo logjike juridike që një recidivisti ti shqiptohet dënim i kushtëzuar.
- Zbatimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore nga secili gjyqtar do të mundësonte unifikimin e politikës ndëshkimore dhe do të ndikojë që të kemi konsistencë dhe trajtim më të barabartë të qytetarëve para ligjit, njëkohësisht do të rrisë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë që janë komponentë të rëndësishme për një shoqëri në të cilën mbizotëron sundimi i ligjit.
- Të pandehurit të cilët kanë dy apo më shumë aktakuza të ngritura të aplikohen dispozitat ligjore për bashkimin e lëndëve dhe të zhvillohet një procedurë e bashkuar

për të pandehurit kur kanë dy apo më shumë aktakuza të ngritura, (kjo mund të bëhet përmes një verifikimi apo kërkimi në sistemin Smil).

- Përfundimisht, vetëm kryerja e numrit të lëndëve që është dukshëm më e lart se numri i lëndëve të pranuar, mund ta mbajë nivelin e efikasitetit në normat e një performance të suksesshme.
- Vëmendje e theksuar lëndëve që janë me urdhërarrestet qendrore dhe atyre me letër rreshtime ndërkombëtare, që pas përfundimit të tyre, urdhërarrestet e tilla të tërhiqen, pasi që secili gjyqtar është përgjegjës për urdhëresat që lëshon dhe çdo ndalim i personave në bazë këtyre urdhërarresteve është përgjegjësi e gjyqtarëve që i kanë lëshuar ato.

➤ **Divizioni Civil**

Prioritetet e DC

- Prioritet i këtij departamenti do të vazhdoj të jetë përpos lëndëve që janë në prioritet ligjor, prioritet i këtij departamenti do të jetë trajtimi i lëndëve të përcaktuara sipas Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Prioritet të jenë trajtimi i lëndëve civile të kthyera në rigjykim ku gjyqtarët duhet të kujdesen që seancat të mbahen brenda një periudhe të shkurtë kohore ashtu siç përcaktohen me Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe të njëjtat të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes.
- Trajtimi i lëndëve të cilat janë më të vjetra se dy vite, gjyqtarët duhet ti respektojnë afatet e arsyeshme kohore sa i përket këtyre lëndëve, pasi që mostrajtimi me kohë i lëndëve mund të ndikoj në uljen e besimit të publikut dhe ndikon në dëmtimin e imazhit të gjykatës.
- Trajtimi i rasteve dhunë në familje në fushën civile gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm që të trajtohen brenda afatit sa më të shkurtë kohor, duke u kujdesur që urdhrat mbrojtës si dhe urdhrat mbrojtës emergjent të lëshohen brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligjin, pasi që mos trajtimi i lëndëve të kësaj natyre ka ndikim negativ edhe brenda familjes dhe për shoqërinë dhe pasojat janë të pariparueshme.
- Trajtimi i lëndëve juridike –statusore (zgjidhja e martesës, besimi i fëmijëve, kontakti me fëmijët e mitur, alimentacioni) duhet të trajtohen me prioritet dhe brenda afatit sa më të shkurtër për shkak të ndjeshmërisë së lëndëve.

- Trajtimi i lëndëve në fushën civile heqja e zotësisë për të vepruar, vendosja dhe mbajtja e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor, vazhdimi dhe pushimi i së drejtës prindërore, heqja dhe kthimi i të drejtës prindërore, dhënia e lejes për lidhje martesore, caktimi i kompensimit për palujtshmërinë e eksproprijuar duhet të trajtohen me prioritet.
- Trajtimi i rasteve në civile vërtetimi i atësisë apo amësisë gjithashtu duhet të trajtohen me prioritetit, pasi që këto ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve si në aspektin emocional po ashtu edhe në atë fizik.
- Trajtim me prioritet i çështjeve përmbartimore në të gjitha natyrat e lëndëve që ka nga kjo lëmi, pasi që kemi një numër të madh të lëndëve përmbartimore dhe duhet një angazhim me i lartë në këtë fushë, në mënyrë që numri i tyre të zvogëlohet duke i trajtuar në mënyrë sa më efektive. Gjyqtari i cili është i angazhuar në këtë lëmi të angazhohet dhe mbikëqyr në baza ditore edhe procedurat e lëndëve tjera përmbartimore që janë të ngarkuar referentët përmbartues, në veçanti lëndët përmbartimore me dokument të besueshëm dhe paushallët gjyqësor.

Procedura civile duhet të thjeshtësohet, të bëhet më fleksibile dhe më e shpejtë, derisa në të njëjtën kohë të mbahen garancionet e ofruara për palët përmes rregullave dhe procedurave ligjore. Në mënyrë që të arrihen këto synime, është e nevojshme që palëve t'u vihen në dispozicion forma më të thjeshtësuara dhe më të shpejta të procedimeve duke i mbrojtur nga vonesa të paarsyeshme, në këtë kontekst, veçanërisht është e rëndësishme që gjyqtarët duhet drejtuar seancat në mënyrë më efektive.

Seancat duhet të përmbajnë jo më shumë se dy (2) seanca dëgjimore, e para nga të cilat mund të jetë seancë paraprake e natyrës përgatitore dhe e dyta për marrjen e provave, dëgjimin e argumenteve dhe nëse është e mundur marrjen e vendimit¹. Gjykata duhet të sigurohet se janë marrë të gjithë hapat e nevojshëm për dëgjimin e dytë dhe që janë brenda afatit, dhe në parim, nuk duhet të lejohet asnjë shtyrje, përpos kur paraqiten fakte të reja apo në rast të rrethanave të tjera përjashtuese apo të rëndësishme.

¹ Rekomandimi Nr. R (84) 5 nga Këshilli i Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Parimet e Procedurës Civile të Dizajnuar për Përmirësimin e Funksionimit të Drejtësisë (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 28 Shkurt 1984 në takimin e 367 të Zëvendës Ministrave.

Gjyqtarët e këtij divizioni duhet të jenë të zellshëm, të tregojnë angazhim të lartë dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje zgjidhjeve të kontesteve më të komplikuar, lëndëve të vjetra, dhe lëndët tjera me prioritet ligjor. Gjithashtu

➤ **Rekomandimet për këtë vit:**

- Aplikim i dispozitave ligjore të cilat racionalizojnë procedurën siç janë: marrëveshjet gjyqësore, aktgjykimet për shkak të pohimit, për shkak të mos bindjes, për shkak të mungesës, aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri në përgjigje në padi ka pohuar faktet vendimtare përkundër kontestimit të kërkesëpadisë e cila autorizon gjykatën që të jap aktgjykimin pa caktuar seancë gjyqësore nëse nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e tij - neni 152 i LPK-së;
- Të vendoset standard që të gjitha ato lëndë përfshirë edhe ato të cilat sapo janë regjistruar të vlerësohet përshtatshmëria për ndërmjetësim, dhe nëse vlerësohen se i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të referohen në këtë procedurë pa vonesa, konform edhe nenit 9 të Ligjit për Ndërmjetësim, dhe për këtë të angazhohen bashkëpunëtorët profesional që janë të angazhuar në zyre të gjyqtarëve, për shqyrtim paraprak të padive, ashtu që pa vonesa të i'u dërgohen të paditurve aktvendimet për përgjigje në padi, vërejtët për taksa nëse nuk i kanë, vlerësimin e kompetencës dhe kjo të bëhet përmes angazhimit të bashkëpunëtorët profesional të cilët janë të caktuar për secilin gjyqtar;
- Vendosja e shpejt dhe brenda standardeve ligjore të lëndëve që janë kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit dhe eventualisht nga Gjykata Supreme;
- Në lëndët përmbartimore, të ndërmerren veprime të menjëhershme për përfundimin e lëndëve të vjetra që janë në punë në këtë zyrë siç janë; alimentacioni, kontakti me fëmijë, lëndët me kthimi i punëtorëve në punë, pengimi posedimi, kolateral, hipoteka, ekzekutimet me vlera të larta si dhe të standardizohet ekzekutimi përmes rrugëve bankare si mënyrë më e përshtatshme, më e sigurt dhe e cila do të sjellë më shumë rezultate. Po ashtu një monitorim i vazhdueshëm gjyqtarit përmbartues në punën e zyrës për ekzekutime civile, me theks të veçantë në kryerjen e lëndëve të vjetra ato me dokument të besueshëm dhe paushallë gjyqësore.

➤ **Divizioni për Kundërvajtje**

Në këtë divizion punojnë dy (2) gjyqtar, të cilët bazuar në statistikat e gjykatës janë të mjaftueshëm që të ballafaqohen me numrin e lëndëve të pranuar në gjykatë, sidomos kur merret në konsideratë fakti se lëndë të kundërvajtjeve të pranuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri për Kundërvajtje, është dukshëm më i ulët, në krahasim me vitet paraprake. Megjithatë duke vështruar numrin e lëndëve të kryera në raport me atë të pranuar në këtë vit, vërehet se në këtë divizion duhet të ketë një angazhim me të madh në kryerjen e lëndëve.

Prioritet i këtij divizioni duhet të jetë trajtimi i rasteve të kthyera në rigjykim edhe pse në gjykatën tonë numri i rasteve të kthyera në rigjykim nuk është i madh, mirëpo sipas ligjit për shkak se afatet në këtë procedurë janë të shkurta, rastet e tilla duhet që brenda 15 ditëve pas kthimit në rigjykim duhet të futen në procesin e punës. Po ashtu trajtimi i rasteve të kundërvajtës që kanë të bëjnë me mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike, mjedisit dhe ambientit dhe rastet e inspekcioneve komunale, gjyqtarët duhet të kujdesen që të trajtohen brenda afatit sa më të shkurtër kohor.

❖ **Rekomandimet:**

- Prioritet i këtij departamenti do të vazhdoj të jetë përpos lëndëve që janë në prioritet ligjor, prioritet i këtij departamenti do të jetë trajtimi i lëndëve të përcaktuara sipas Planit Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- Të përfundohet numër sa më i lartë i lëndëve, në mënyrë që të krijohet kultura e respektimit të ligjit dhe të pengohet maksimalisht parashkrimi i lëndëve;
- Rëndësi prioritare zgjidhjes së lëndëve pa vonesa që vijnë nga inspektoratet e ndryshme, si ato të ministrive, komunave apo agjensioneve të pavarura për shkak të natyrës dhe ndjeshmërisë, këto lëndë duhet të kenë vëmendje në trajtimit nga ana e gjyqtarëve.
- Rishikimi i politikës ndëshkimore që dënimet të jenë proporcionale duke pasur në konsideratë në veçanti preventivën gjenerale.

➤ **Komunikimi me Institucionet e tjera veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprimtarinë e gjykatës**

Gjykata do të mbaj komunikim mbi baza të rregullta dhe të vazhdueshme me institucionet veprimtaria e të cilave ndikon në punën e gjykatës, në mënyrë që tek këto institucione veprimtaria e gjykatave të jetë në agjendat prioritare të tyre.

Bashkëpunimi me policinë sidomos në çështjet e ekzekutimit të urdhëresave, do të monitorohet mbi baza mujore dhe do të ketë takime të rregullta me drejtues të policisë, përkitazi me ecurinë e zbatimit të urdhëresave. Gjithashtu me njësinë për sjelljen e personave të paraburgosur do të ketë koordinim të duhur në mënyrë që mos të ketë dështim apo vonesa të seancave të caktuara.

Planifikohen takime edhe me drejtues të institucioneve tjera si: Policinë e Kosovës, Qendrat Korrektuese, Shërbimi Sprovues, Postë Telekom i Kosovës etj, në funksion të ngritjes së efikasitet të punës së Gjykatës dhe evitimit të pengesave të mundshme.

Përfundimi

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj, viti 2024 do të jetë, vit i monitorimit të zbatimit të dokumenteve strategjike të aprovuara nga KGJK, me një vëmendje të posaçme monitorimit në zgjidhjen e lëndëve të vjetra, lëndëve me prioritet dhe lëndëve në rigjykim dhe rivendosje. Do të kujdesimi që gjyqtarët dhe gjykata të jetë aktive në procedimin e çështjeve duke e minimizuar kohën pasive të lëndës, ashtu që edhe këtë vit do të angazhohemi në kontrollin paraprak të padive në kohën sa më të shkurtë, në mënyrë që të identifikohen lëndët të cilat mund të përfundohen në këtë fazë apo edhe të eliminimit të mangësive në periudhën sa më të hershme të procedimit të tyre.

Bashkëpunëtorët profesional të angazhuar në gjykatë janë shpërndarë në mënyrë proporcionale dhe në bazë të kritereve të përcaktuara nga KGJK-ë, andaj nga secili gjyqtar do

të kërkohet që angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional të jetë maksimal sidomos në lëndët ku potencialisht plotësohen kushtet që të përfundohen jashtë seancave gjyqësore (divizioni civil psh. tek lëndët apo kërkesat që kanë të bëjnë me kontratat kolektive), pasi që angazhimi racional i tyre që nga faza e hershme e pranimit të lëndës në gjykatë që në fazën e shqyrtimit paraprak të lëndës mund të jetë ndihmesë e madhe si për gjyqtarin me të cilin është caktuar ti ofroj mbështetje profesionale, po ashtu edhe për gjykatën.

Ky plan dhe program mund të ndryshohet dhe plotësohet nga kryetari i gjykatës varësisht nga nevojat për organizimin më efektiv të punëve, zgjidhjen më efikase të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, është i zbatueshëm për vitin 2024.

Obligohet Zyra për Informim, të publikoj këtë plan/program në ueb faqen e gjykatës.

Datë: 22 dhejtor 2023

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

Me këtë plan do të njoftohen:

*Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
Gjykata Supreme e Kosovës dhe
Gjykata e Apelit e Kosovës.*